

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER RIDVANA G. RUÇI**



**DATE 26/04/2021
NR REP 3006**

VËRTETIM NJËSIE ME ORIGINALIN

Sot, më datë 26/04/2021, para meje Noteres RIDVANA G. RUÇI, Anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën KAJO KARAFILI, u paraqit personalisht:

KËRKUES/IT:

Ergest Osmani, atësia Kujtim, amësia Zaide, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë H.Tasin 230; Njësia Administrative Nr. 2; 0000; Tiranë, lindur më 19/05/1982, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036018713 dhe nr. personal I20519146S, .

I cili me kerkoi te vertetoj me origjinalin fotokopjen e dokumentit:

"Vendim per leshimin e Deshmise se Trashegimise Ligjore me nr. 3005Rep , nr. 986Kol , Tiranë me 26.04.2021 leshuar per te ndjerin Kujtim Ramadan Osmani."

Unë Noterja, pasi i bëra të qartë personit të mësipërm, përgjegjësinë penale në rast paraqitje të dokumenti të rremë; bëra krahasimin e përmbajtjes së dokumentit origjinal me fotokopjen e paraqitur, mbi të cilat më rezultoi se nuk janë bërë korrigjime, shtesa, fshirje, a shenja të tjera të dyshimta.

Si rrjedhim, në bazë të nenit 62, shkronja "i", nenit 129 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë"; Vërtetoj se fotokopja e dokumentit të paraqitur nga kërkuesi para meje Noteres, është e njëjtë me dokumentin origjinal.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të kërkuesit të këtij dokumenti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.



NOTER

RIDVANA G. RUÇI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER RIDVANA G. RUÇI
ADRESA KAJO KARAFILI
TEL: 683030361

VENDIM PËR LËSHIMIN E DËSHMISE SË TRASHËGIMISË LIGJORE

Nr. repertori: 3005

Nr. koleksioni: 986

Tirane më 26/04/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

*Akti noterial përbëhet nga 4 fletë



A2021053240091784844



LËSHIMI I DËSHMISË
SË TRASHËGIMISË LIGJORE

Sot, më datë 26/04/2021, para meje Notere RIDVANA G. RUÇI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, KAJO KARAFILI, u paraqit personalisht:

KËRKUES: Ergest Osmani, atësia Kujtim, amësia Zaide, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë H.Tasin 230; Njësia Administrative Nr. 2; 0000; Tiranë, lindur më 19/05/1982, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036018713 dhe nr. personal I20519146S, .

OBJEKTI: Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për të ndjerin Kujtim Ramadan Osmani.

BAZA LIGJORE: Nenet 316, 317, 318, 348, 360, 361 e vijues i ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet, neni 61, pika 1, shkronja d, j; nenet 97, 111, 112, 113 e vijues të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”.

Pasi administrova në tërësi provat shkresore të prezantuara nga kërkuesi dhe dëgjova pretendimet e tij, Unë Noterja kryesisht, bazuar në nenin 111, 113 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”, përpara shqyrtimit të bazueshmërisë në ligj e në prova të kërkesës, verifikova dhe konstatova se kjo çështje hyn në kompetencën e Shërbimit Noterial, të Degës Vendore Tiranë, përkatësisht Notere RIDVANA G. RUÇI, me zyrë Noterie në Tirane, KAJO KARAFILI, territor mbi të cilën shtrin kompetencën kjo zyrë për shqyrtimin e kësaj kërkesë. Në këto kushte,

VËREJ SE:

Z.Ergest Osmani ka depozituar në zyrën time noteriale, kërkesën nëpërmjet së cilës kërkon lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin, babain e tij të ndjerin Kujtim Osmani, atësia Ramadan dhe amësia Sanije, i datelindjes 01.09.1955 vendlindja Tiranë i cili ka nderruar jete me date 28.12.2019 në qytetin e Tiranës.

Në këto rrethana rezulton se kërkuesi ka interes të ligjshëm në paraqitjen e kësaj kërkesë për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë.

Sipas përgjigjes që kam marrë nga baza e të dhënave të Dhomës Kombëtare të Noterëve (Regjistri i Testamenteve dhe Dëshmive të Trashëgimive), ka rezultuar se trashëgimlënësi Kujtim Osmani, nuk ka lënë testament. Në këto rrethana, unë noterja, në përputhje me nenin 348 të Kodit Civil procedoj me lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për këtë trashëgimlënësë.

Sipas dokumentacionit të paraqitur nga kërkuesi, rezulton se Kujtim Osmani, atësia Ramadan dhe amësia Sanije, i datelindjes 01.09.1955 vendlindja Tiranë ka nderruar jete me date 28.12.2019 në qytetin e Tiranës. Kjo provohet nga çertifikata e vdekjes leshuar në date 25.03.2021 nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Administrative nr.2 374, Bashkia Tiranë, ku vertetohet se Kujtim Osmani, atësia Ramadan dhe amësia Sanije, i datelindjes 01.09.1955 vendlindja Tiranë ka nderruar jete me date 28.12.2019 në qytetin e Tiranës.

Në këto rrethana, sipas nenit 318 të K. Civil në fuqi, që në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit konsiderohet se është çelur edhe trashëgimia e tij. Po kështu, sipas nenit 318/1 trashëgimia çelet në vendin ku ka pasur vendbanimin e fundit trashëgimlënësi, që është qyteti Tiranë. Per rrjedhojë, në bazë të nenit 348/2 të Kodit Civil dhe ligjit “Për noterinë”, unë noterja, kam kompetencën tokësore për shqyrtimin e kësaj kërkesë.

Nga ana tjetër, sipas nenit 318/2 të Kodit Civil trashëgimia rregullohet sipas ligjit të kohës kur është çelur, që në rastin në shqyrtim janë dispozitat e Kodit Civil të RSH aktual.

Sipas nenit 320 të Kodit Civil, zotësi për të trashëguar kanë vetëm personat që në kohën e vdekjes së trashëgimlënëses ishin gjallë ose ishin zënë para vdekjes së saj dhe kanë lindur të gjallë. Ndërsa në nenin 360 të K. Civil parashikohet se trashëgimia ligjore vepron sipas radhëve, pra personat që thirren në trashëgim në një radhë të caktuar përjashtojnë ata të radhëve pasardhëse.



A202105324009178484

Konkretisht, Neni 361 i Kodit Civil aktual, përcakton në paragrafin e parë të tij si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë bashkëshortin dhe fëmijët me formulimin: «Në rradhë të parë thirren në trashëgim fëmijët dhe bashkëshorti i aftë ose i paaftë për punë, duke trashëguar secili në pjesë të barabarta»

Nga verifikimi i çertifikatave të përbërjes familjare të të ndjerit dhe i çertifikatave përkatëse të lindjes të paraqitura nga kërkuesi rezulton se në momentin e vdekjes trashëgimlënësi Kujtim Osmani ka qenë me gjendje civile- i martuar, dhe bashkëshortia e tij Zaide Osmani, ka qenë gjalle në kohën kur ka ndërruar jete trashëgimlënësi, dhe vazhdon të jete gjalle edhe sot, vertetuar sipas Certifikates Personale. Nga martesë e tyre kanë lindur 2 (dy) fëmijë, dhe konkretisht Ergest Osmani, i datelindjes 19.05.1982 dhe Xhilda Ferhati, e datelindjes 09.04.1988. Me vendim të Komitetit Ekzekutiv Kesh.Popullor me nr.42 date 26.11.1979 behet ndryshimi i mbiemrit nga "OSMANAGAJ " ne "OSMANI".

Referuar Nenit 361 të Kodit Civil , Në rradhë të parë thirren në trashëgim fëmijët dhe bashkëshorti i aftë ose i paaftë për punë, duke trashëguar secili në pjesë të barabarta..

Konkretisht, nga unë noterja u administruan si prova çertifikatat e mëposhtme:

1. Çertifikate vdekje e trashëgimlënësit Kujtim Osmani, leshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Adimstrative nr.2 374 ; ne daten 25.03.2021
2. Çertifikate martese me bashkëshorten, Zaide Osmani , leshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Bashkia, Tiranë ne daten 25.03.2021
3. Certifikate e Perberjes familjare te vitit 1950-1974 leshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Tiranë, me date 25.03.2021
4. Certifikate familjare per gjendjen familjare per vitin.1991 leshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Tiranë dhe certifikate familjare ne baze te Regjistrimit Kombetar te Gjendjes Civile te vitit 2010.
5. Certifikate familjare per gjendjen familjare me date 22.02.2019, leshuar prej Zyres se Gjendjes Civile Tiranë, date 25.03.2021
6. Certifikate familjare dhe Certifikata personale per secilin nga trashëgimtarët.

Nga të gjitha çertifikatat e paraqitura – të administruara nga unë noterja, rezulton se fëmijet e trashëgimtareve e trashëgimlënësit kanë qenë gjallë në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit dhe janë gjalle edhe sot. Gjithashtu, nga hetimi nuk rezulton se:

- Ndonjë nga trashëgimtarët të ketë hequr dorë nga trashëgimi, të jetë shpallur i padenjë për të trashëguar me vendim gjykatë, apo të jetë përjashtuar nga trashëgimia e të ndjerit.
- Që trashëgimlënësi të ketë pasur martesë të mëparshme, të ketë pasur fëmijë të tjerë jashtë martese, apo të birësuar.
- Kerkuesi me deklaroi se, nuk ka trashëgimtare të tjere ligjore, pervec atyre te pasqyruar ne certifikaten familjare dhe te pasqyruar ne certifikatat e lindjeve te depozituara prej tij.

Për sa më lart, trashëgimtarët ligjor të trashëgimlënësit janë bashkëshortja Zaide dhe dy fëmijet e tij Ergest Osmani dhe Xhilda Ferhati të cilet e trashëgojnë trashëgimlënësin në masën e 1/3 të pasurisë trashëgimore dhe mbartin detyrimet e tij në të njëjtën masë.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenet: 316, 317, 318, 320, 348, 360 e vijues të Kodit Civil, dhe neni 61, pika 1, shkronja d, j; nenet 97, 111, 112, 113 e vijues të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për noterinë",

VENDOSA:

- Pranimin e kërkesës.
- Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin Kujtim Osmani duke përcaktuar si trashëgimtar ligjorë të radhës së parë bashkëshortja dhe fëmijet e tij :
- 1. Zaide Osmani, atesia Hamdi dhe amesia Bedrije, lindur me 10.07.1958 ne Tiranë dhe me banim ne Tiranë, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtese e leternjoftimit me nr.personal F85710197M , me shtetesi shqiptare dhe gjendje civile – e ve.



A202105324009178484

2. Ergest Osmani atesia Kujtim dhe amesia Zaide lindur me 19.05.1982 ne Tirane dhe me banim ne Tirane, me shtetesi shqiptare, dhe gjendja civile- beqar , madhor me zotesi juridike per te vepruar, mbajtes i dokumentit te identifikimit me nr.personal I20519146S.
3. Xhilda Ferhati, atesia Kujtim dhe amesia Zaide , lindur me 09.04.1988 ne Tirane dhe me banim ne Tirane, me shtetesi shqiptare, dhe gjendja civile- e martuar , madhor me zotesi juridike per te vepruar, mbajtes i dokumentit te identifikimit me nr.personal I85409076T.

Te cilët trashëgojnë në mënyrë të barabartë nga 1/3 (një të tretën) pjesë të pasurisë trashëgimore të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe detyrimet përkatëse të trashëgimlënësit.

Kërkuesi mori dijeni dhe iu sqarua nga Noterja detyrimi ligjor për depozitim të dëshmisë së trashëgimisë ligjore në institucionin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, brenda afatit ligjor prej 30 (tridhjetë ditë kalendarike), nga data e lëshimit të saj. Në rast të kundërt, për çdo ditë vonese, aplikohen penalitetet përkatëse sipas dispozitave ligjore në fuqi, referuar nenit 25, pika 2 e ligjit 111/2018 “Për Kadastrën”.

Dëshmia e trashëgimisë, pavarësisht rrethit të trashëgimtarëve në çastin e regjistrimit pranë institucionit përgjegjës për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, nuk mund të çenohet pjesën e bashkëshortit të prezumuar bashkëpronar për pasuritë e përfituara përgjatë martesës. Nëse trashëgimlënësi ka pasuri bashkëshortore të përfituara përgjatë martesës, por të regjistruara në institucionin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, vetëm në emrin e tij, regjistrimi i pjesës takuese të trashëgimisë ligjore do të bëhet duke zbritur 1/2 pjesë të prezumuar të bashkëshortit pasjetues, në referim me nenin 76 të Kodit Civil, nenit 112, pika e ligjit 110/2018 “Për Noterinë”. Gjithashtu nëse trashëgimlënësi është i prezumuar bashkëpronar në ndonjë nga pasuritë e regjistruara në institucionin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, atëherë, pjesa e prezumuar e bashkëpronësisë së tij do të kalojë tek trashëgimtarët ligjorë sipas pjesëve takuese. Bashkëlidhur certifikata e martesës nr. akti nga Akti i martesës nr. 117, datë 03.09.1980 midis Kujtim Osmani dhe Zaide Osmani, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, nr. seria 016656315, Tiranë datë 25.03.2021, referuar nenit 112, pika 3 e ligjit 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”.

Shpenzimet Noteriale i ngarkohen kërkuesit.

Kjo dëshmi trashëgimie përbëhet nga 3 (tre) fletë dhe lëshohet në kopje origjinale nga të cilët, njëri depozitohet në arkivin e zyrës noteriale, nga një kopje i dorëzohet kërkuesit për ta paraqitur në institucionet përkatëse (për aq pasuri sa disponon) dhe nga një kopje u jepet trashëgimtarëve ligjorë.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë Noteri/ja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj dëshmie, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

Kundër këtij vendimi për lëshim dëshmi trashëgimie ligjore, mund të bëhet ankim në Gjykatën kompetente, sipas rregullave për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Dëshmia e trashëgimisë ligjore lëshohet në Tirane, sot më datë 26/04/2021

NOTER

RIDVANA G. RUÇI



A202103324009178484

Ergest Osmani, si pale kerkuese per leshimin e deshmise se trashegimise ligjore ne emer te trashegimlensesit Kujtim Osmani, sot me date 26/04 /2021, u pajisa me vendimin nr 3005 Rep, nr. 986
Kol., date 26/04 /2021, me objekt: Vendim "Per leshimin e deshmise se trashegimise ligjore per trashegimlensesin Kujtim Ramadan Osmani.

Me ane te kesaj, vertetoj se mora prane Zyres se Noterise Tirane, te Notere Ridvana G. Ruçi, vendimin e sipercituar duke nenshkuar kete vertetim.

Ergest Osmani